

# **SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A**

## **SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE**

### **SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE**

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkzionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

#### **1( nje) Punonjes Sherbimi Theth**

#### **Detyrat dhe pergjegjesite kryesore**

1. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është:
2. Mirëmbajtja dhe riparimi i defekteve të të gjithë veprave hidrike në funksion të prodhimit dhe transmetimit të cilat janë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Shoqërisë-së.
3. Realizimi i punimeve për riparimet në shkarkuesit, ajruetit, pusetat kryesore, nyjet hidroteknike, riparimin dhe zëvendësimin e saraçineskave në linjat e transmetimit, në ato shpërndarëse dhe në depot, stacionet e pompimit etj., në zonën administrative të Shoqërisë-së.
4. Mirëmbajtja, monti periodik dhe riparimi i të gjitha pajisjeve elektro-mekanike që shërbejnë për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm dhe të cilat janë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Shoqërisë-së.
5. Zbaton detyrat dhe urdhrat e punës të dhëna nga Përgjegjësi i Njesisë së Mirëmbajtjes dhe kryen procesin e punës të caktuar prej tij.
6. Zbaton brenda kritereve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga Përgjegjësi i Njesisë së Mirëmbajtjes dhe raporton për realizimin e tyre.
7. Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi i Njesisë së Mirëmbajtjes dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.
8. Zbaton në çdo kohë, sipas udhëzimeve të eprorëve rregullat dhe masat e sigurimit teknik në punë.
9. Njofton Përgjegjësin e Njesisë së Mirëmbajtjes, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tij.

10. Është në gatishmëri edhe pas kohës së punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence.
11. Zbatimi i projekt planeve vjetore të remontit dhe mirëmbajtjes parandaluese të miratuara nga Departamenti Teknik.
1. Bashkëpunimi me Drejtorinë Teknike, zbatimi i udhëzimeve të tyre dhe sipas nevojës mbështetja e tyre gjatë riparimeve dhe remonteve të infrastrukturës së furnizimit me ujë në zonën administrative të Shoqërisë.

Mban përgjegjësi, sipas shkallës së dëmit dhe rrezikshmërisë, për të gjitha veprimet e kryera në kundërshtim me Urdhrat e dhëna nga Eprorët, apo për mos realizimin në afat dhe me cilësi të detyrave të ngarkuara

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

### **DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT**

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor ( Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 10 dite.

Kandidatet do të vleresohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.